

**Akt Themelimi**  
**i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“DEJA 2025” sh.p.k**

**Neni 1**  
Formimi

Sot më dt. 03/11/2025 themeluesit që firmosin më poshtë:

- z. Urim VATA shtetas Shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, i lindur në Macukull, më dt. 25.04.1975, dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H50425083W.

Në bazë të Ligjit Nr. 9901, Dt.14.04.2008, “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe të Ligjit Nr. 9723, Dt.03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, themelojnë me vullnet të plotë dhe të lirë shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “**DEJA 2025**” sh.p.k.

**Neni 2**

Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**DEJA 2025**” sh.p.k, është Adresa Rruga Myslym Shyri Nr pas. 4/347-N9 VOL 20 FQ 30 ZK 8250 Tirane Shqipëri.

**Neni 3**

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**DEJA 2025**” sh.p.k., është pa afat nga momenti i regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 4**

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “**DEJA 2025**” sh.p.k, është:

Bar - Kafe Lounge

**Neni 5**

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë “**DEJA 2025**” sh.p.k është 50.000 lekë dhe i përbërë nga kontributi i ortakut si më poshtë:

Z. Urim VATA, në masën 100 % (Njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortaku themelues, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të merr ortaku, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

**Neni 6**

Organet e shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë “**DEJA 2025**” sh.p.k janë:



- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim-marrës
- Administrator është Z. Urim VATA shtetas Shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, i lindur në Macukull, më dt. 25.04.1975, dhe banues në Tirane mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H50425083W. Kohëzgjatja e administratorit është për një periudhë 5 vjeçare, deri në dt. 02.11.2030.

#### **Neni 7**

##### **Organizimi i shoqërisë**

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, shprehen në statusin e shoqërisë që së bashku me aktin themelimit janë dokumentacioni bazë i veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

#### **Neni 8**

##### **Legjislacioni**

Në lidhje me veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin që aplikohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 9**

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statuti dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me gjykatë.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e rregjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**DEJA 2025**” sh.p.k në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe në këtë ditë shoqëria “**DEJA 2025**” sh.p.k përfiton statusin e personit juridik.

#### **Ortaku Themelues I Shoqërisë**

**Urim VATA**

